



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 113 dt. 11.11.2014

Në mbështetje të nenit 17, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 11.11.2014, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit të rikonstruksionit të godinës së MAS, rruga e Durrësit, Tiranë.  
*Të ruhet rrethimi monumental. Të modifikohet rrethimi në pjesën e hyrjes së re të propozuar.*  
*Hyrja ekzistuese të ruhet.*  
*Të realizohet hapja e dritares këndore në katin përdhe, për të realizuar hyrjen e re në objekt, por pa ndryshuar detajet e kornizës.*  
*Të hiqet frontoni mbi hyrjen ekzistuese.*
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**



**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**